

SHOQERI TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“CONFORTCLIMA” SHPK

AKT THEMELIMI

Ne DURRES, sot me date 11/02/2022, ditën e Premte, shtetasit të identifikuar si më poshtë:

1. PANAJOT BIRI, atesia Aleksandro, amesia Rajmonda, lindur me 18/07/1988, shtetas shqiptar, lindur në Durres dhe banues në Durres, i pranishëm në këtë akt nën çelësinë e njerit prej ortakeve themelues;
2. ERNEST PERONA, atesia Ilir, amesia Alketa, lindur me 02/10/1998, shtetas shqiptar, lindur në Sul, Devoll dhe banues në Durres, i pranishëm në këtë akt nën çelësinë e njerit prej ortakeve themelues,

bazuar në:

- * Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
- * Në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 « Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare »
- * Në Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 « Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ».

Krijojnë shoqërinë **“CONFORTCLIMA” SHPK** si më poshtë:

NENI 1

Personat e sipërpermendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe në liri të plote, themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **“CONFORTCLIMA” shpk**. Ky emërtim do të jetë i stampuar edhe në vulën e shoqërisë.

Ortaket e shoqërisë të cilet do të ndajnë mes tyre kuotat e kapitalit me vlerë nominale prej 100.000 (njëqind mijë) lekesh do të jenë si më poshtë:

1. PANAJOT BIRI, atesia Aleksandro, amesia Rajmonda, lindur me 18/07/1988, shtetas shqiptar, lindur në Durres dhe banues në Durres, me kartë identiteti numer 032321062, numer identifikimi personal I807180910, do të jetë titullar i 50% të kapitalit të shoqërisë ose 1 kuote me vlerë nominale 50'000 leke;
2. ERNEST PERONA, atesia Ilir, amesia Alketa, lindur me 02/10/1998, shtetas shqiptar, lindur në Sul, Devoll dhe banues në Durres, me kartë identiteti numer 033299531, numer identifikimi personal J81002039H, do të jetë titullar i 50% të kapitalit të shoqërisë ose 1 kuote me vlerë nominale 50'000 leke.

Nga sa u tha më lart, secili ortak zoteron të drejtën e 1 vote me peshe vendimarrëse në bazë të kapitalit të shoqërisë që ai disponon.

NENI 2

Shoqëria **“CONFORTCLIMA” sh.p.k** me regjistrimin e saj pranë organeve kompetente gëzon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do të zhvillohet sipas pikave të paraqitura në këtë akt themelimi, statutit të saj dhe ligjeve në fuqi.

Selia e saj është me adresë në DURRES, Lagjja nr. 3, Rruga **“Egnatia”**, banesa **“N.A.T.O.J.A.”**. Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë integrale e tij.

NENI 3

Shoqëria shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës Shqiptare.

Me Vendim unanimit të Ortakëve mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë celur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë.

NENI 4

Shoqëria "CONFORTCLIMA" SH.P.K ka si objekt të saj:

1. Tregëtim të sistemeve ngrohje-ftohje, kondicionere, pjesë këmbimi/riparimi të sistemeve ngrohje-ftohje dhe të kondicionereve dhe instalimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

NENI 5

Kapitali Themeltar i kësaj shoqërie është në likuiditet, i formuar dhe nënshkruar nga ortakët në shumën **100.000 (njëqind mijë) leke**, që zënë 100% të Kapitalit themeltar.

Kapitali ndahet në kuota, gjithsej në 2 kuota me vlerë nominale **sic parashikohet në nenin 1 të këtij akti** dhe 1 kuota është e barabartë me 1 votë me të drejtë vendimarrëse.

Nga sa u tha më lart, secili ortak zotëron të drejtën e 1 vote me peshe vendimarrëse në bazë të kapitalit të shoqërisë që ai disponon.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i perfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, nuk do të bëhet para kërkesës së drejtuar Qendres Kombëtare të Biznesit për njohjen dhe regjistrimin e saj si Person Juridik. Kjo vlerë do të derdhet në një kohë të dytë kur ortakët do të cilesojë të arsyeshme.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është **PA AFAT**, duke filluar nga dita e Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit, për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person Juridik.

Me Vendim të Ortakut, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky Vendim dërgohet menjëherë për depozitim QKB-se, kompetente për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 8

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plote me Legjislativën Shqiptare në fuqi, Konventat ndërkombëtare të gjithëpranuara si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.



NENI 9

Ne mbeshtetje te neni 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administrator i kesaj shoqerie do te emerohet per nje periudhe 5 vjecare e cila shtrihet nga 11/02/2022 deri me 10/02/2027, Z. Ernest Perona te cilit i perkasin te dhenat identifikuese si me poshte:

ERNEST PERONA, atesia Ilir, amesia Alketa, lindur me 02/10/1998, shtetas shqiptar, lindur ne Sul, Devoll dhe banues ne Durres, me karte identiteti numer 033299531, numer identifikimi personal J81002039H.

Ketij shtetasi nen cilesine e administratorit te vetem te shoqerise i caktohen te gjitha fuqite e administrimit me perjashtim te atyre te cilat me ligj dhe statut jane nen kompetencat e asamblese se ortakeve.

NENI 10

Pjese e Kapitalit Themelor, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie ligjore ose testamentare, sipas dispozitave te Kodit Civil, dhe ortaket gezojne te drejten e shitjes se kuotave ne mes tyre ose jashte ortakerise, mbi bazen e vendimit te Asamblese Ortakeve dhe sipas procedurave qe jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Ortaku ka te drejte te transferoje jashte territorit te Republikes pjesisht ose teresisht kontributet e tyre, perfshire dhe fondet dhe vlerat e kontributit ne Natyre ose **nepermjet fitimit te realizuar** bazuar ne te drejten qe u njeh neni 7 Ligjit Nr. 7764 date 02.11.1993 "**Per Investimet e Huaja**" **Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themelor**, duhet te jene te vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendim me shkrim. Shoqeria dhe te trete, respektojne keto transferime sapo te behen te ditura.

NENI 11

Me Vendim te Ortakut, ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen Fonde te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te Kapitalit ne Natyre.

NENI 12

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne Pronesi, Ortakeve te Shoqerise.

NENI 13

Per detyrimet ndaj te treteve qe do te krijohen gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet eskuzivisht vetem me kapitalin e saj. per rrjedhoje, ortaku/ortaket nuk do te kene asnje pergjegjesi per detyrimet e krijuara nga shoqeria, pervecse brenda kufijve te kapitalit te vete shoqerise. Quhet e mireqene se me regjistrimin e ketij akti prane Qendres Kombetare te Biznesit – QKB do te konsiderohet i permbushur detyrimi i njoftimit te ortakut te vetem sic parashikohet ne neni 71 te ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".



NENI 14

Me Vendim te Asamblese Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere. Shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroje Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet me mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

NENI 15

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit mbi bazen e kontributit te Ortakeve te vetem, menyra e Drejtimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqerise ose shnderrimi i saj ne nje forme tjeter te Shoqerise Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregtare vendase apo te Huaja, ndarja apo menytrat e falimentimit te saj dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise. Per gjithcka qe nuk eshte specifikuar ne kete akt apo statutin e shoqerise do ti referohemi ne menyre te drejtperdrejte ligjeve kompetente ne fuqi.

NENI 17


Kjo Kontrate Themelimi u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi lexohet, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te Shoqerise tregtare "**CONFORTCLIMA**" **Sh.p.k** te perfaqesuar ne kete akt personalisht nga ortaket dhe nenshkruhet prej tyre ne te gjithe ekzemplaret duke vene emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale, autentiviteti i te cilave vertetohet dhe nga Noteri.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE

"CONFORTCLIMA" SHPK DURRES – SHQIPERI

Miratues te ketij AKT THEMELIMI

PANAJOT BIRI

z. PANAJOT BIRI 

ERNEST PERONA

z. Ernest Perona 